

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Plagosja e avokatit në mes të lokalit, Dhoma Vendore e Avokatisë 2 orë bojkot të seancave gjyqësore në Durrës – Vizion Plus
ADRESA	https://www.vizionplus.tv/plagosja-e-avokatit-ne-mes-te-lokalit-dhoma-vendore-e-avokatis-e-2-ore-bojkot-te-seancave-gjyqesore-ne-durres/
BURIMI	vizionplus.tv
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 07:36:44 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 07:34:53 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a9cb02c87c0c5a848376256a15f5f9ec034cdca06a5122090eb28ede376d4dfc
TEKSTI	20991d121be567412e21c4069bcc8be6b6eb9a7dcb6d679c6135ea615ea33325
PAMJA	ba8f7b37dcd31c57a4fe99b9081d3af9e3a142cee0bc44da4b6750dfa58ed21f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	27a9209a418bf266ffd6c59de409d2df8045bd6d9ce2d8b0a770974eaaac1e4e
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	401dcacf3311c18d7b93cbabfd522e0d009d4ac62bab22fd89058a16395500d64
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/27a9209a418bf266ffd6c59de409d2df8045bd6d9ce2d8b0a770974eaaac1e4e>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



proteste pas plagosjes me arme te avokatit Elton Shllaku dy dite me pare, pas një konflikti banal në një lokal në lagjen nr. 1 të qytetit.

Dhoma Vendore e Avokatisë Durrës vendosi të pezullojë pjesëmarrjen në seanca nga ora 08:00 deri në 10:00, duke kërkuar rritjen e sigurisë për avokatët gjatë ushtrimit të detyrës.

Vendimi, i firmosur më 17 shtator, i është drejtuar edhe Prokurorisë dhe Policisë së Durrësit. Prokurorisë i kërkohet një hetim i shpejtë dhe i plotë për zbardhjen e rrethanave të ngjarjes dhe përcaktimin e përgjegjësive ligjore.

Ndërkohë, nga Policia e Durrësit kërkohet informacion mbi ecurinë e hetimeve dhe masat e ndërmarra për dokumentimin e plotë të rastit.

Çështja e sigurisë së avokatëve pritet të jetë në fokus edhe të mbledhjes së ardhshme të Këshillit të Përgjithshëm të Dhomës së Avokatisë.

Elton Shllaku u qëllua me armë në dorë dy ditë më parë, në një lokal në shëtitoren "Taulantia" në Durrës. Policia vijon kërkimet për kapjen e autorit të dyshuar, Fatmir Ferhati.

Avokatët kërkojnë zbardhjen e plotë të ngjarjes dhe marrjen e masave konkrete për garantimin e një mjedisi më të sigurt gjatë ushtrimit të profesionit.

5 "E ke zednenesin gati", Berisha paralajmëron një tjetër socialist: Do ...

NEWSLETTER

Përmbledhja e ditës në e-mail

Abonohu



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA VENDORE E AVOKATISË Durrës

Nr 178/1 prot

Durrës më 17.09.2026

Vendim nr.74 datë 17.09.2026

Komiteti Drejtues i Dhomës Vendore të Avokatisë Durrës, së bashku me anëtarët e Kryesisë së Dhomës Vendore të Avokatisë Durrës në Këshillin e Përgjithshëm, pasi u njohën me ngjarjen e rëndë të ndodhur ndaj kolegut, Av. Elton Shllaku, dhe pasi, në një mbledhje urgjente, shqyrtuan informacionet e marra nga Drejtoria Vendore e Policisë Durrës, sipas të cilave motivi i konfliktit lidhet me një konflikt gjyqësor pronësie, duke e konsideruar këtë ngjarje si të lidhur me ushtrimin e detyrës profesionale të avokatit dhe duke vlerësuar edhe një herë se siguria dhe jeta e avokatëve gjatë ushtrimit të profesionit kërkojnë vëmendje dhe mbrojtje të posaçme institucionale, në shenjë solidariteti dhe sensibilitizimi,

VENDOSI

1. Bojkotimin e seancave gjyqësore pranë Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, në të dy seksionet, civile dhe penale, nga ora 08:00 deri në orën 10:00, në shenjë solidariteti me kolegut Av. Elton Shllaku.
2. T'i drejtohet Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, znj. Suela Beluli, me kërkesën për zhvillimin e një hetimi sa më të shpejtë, të plotë dhe gjithëpërfshirës, me qëllim zbardhjen e plotë të rrethanave të ngjarjes dhe vënien përpara përgjegjësisë ligjore të personave përgjegjës.
3. T'i drejtohet Drejtorit të Policisë së Qarkut Durrës, z. Ervin Hodaj, me kërkesën për informacion të mëtejshëm lidhur me rrethanat e ngjarjes, si dhe për marrjen e të gjitha masave të nevojshme në kuadër të kompetencave ligjore për zbardhjen e saj.
4. Nga ky bojkot dyorësh përjashtohen seancat gjyqësore që kanë objekt shqyrtimin e masave të sigurimit.
5. Të njoftohet Komiteti Drejtues i Dhomës së Avokatisë Tiranë për këtë situatë dhe çështja e sigurisë së avokatëve gjatë ushtrimit të profesionit t'i referohet mbledhjes së radhës së Këshillit të Përgjithshëm.

Kryetari i Dhomës Vendore të Avokatisë Durrës

Av. Lorval PETANI

#dhomaeavokatisë



Xhuljana Zhuleku

Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

Vazhdo të lexosh



POLITIKË

Rama mbledh ministrat dhe...

Xhuljana Zhuleku 12 minuta më parë



VENDI

Lojëra fati në lokal dhe kanabis,...

Xhuljana Zhuleku 29 minuta më parë



VENDI

Baste sportive pranë shkollave në...

Xhuljana Zhuleku 57 minuta më parë

Lini një koment

Komenti juaj *

Me respekt — komentet moderohen nga redaksia.

